



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTSH DELFINA" të datës 12.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikujt që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 033 121, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET si e palejuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTSH DELFINA" e datës 12.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikujt që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 033 121.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues për nënshkrim të kontratës duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën hyn në fuqi ky vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "NTSH DELFINA" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "NTSH DELFINA" (tutje "parashtruesi") me datë 12.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikujt që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 033 121.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është dorëzuar me datë 12.04.2023 pas orarit zyrtar të punës përkatësisht në ora 19:15 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023 i cili është publikuar brenda orarit të punës përkatësisht në ora 13:33. Kjo nënkupton që kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas më shumë se pesë (5) ditëve nga njoftimi mbi vendimin që është goditur me kërkesë.

Përmes nenit 60.1. paragrafin b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") përcaktohet se "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit (ajo mund të parashtrohet) brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58)". Tutje përmes nenit 62.1. paragrafit a) të RRPP përcaktohet se "Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj rregullore".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60.1 paragrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63.1.1. paragrafin a) lidhur me nenin 62.1. paragrafin a) si dhe nenin 60.1. paragrafin b) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 19.04.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.